



Republika e Kosovës / Republic of Kosova  
Komuna - Municipality  
Hani i Elezit



01/Nr. 2237/2024  
Data: 20.03.2024

### PROCESVERBAL I KUVENDIT TË KOMUNËS

Procesverbali nga mbledhja e dytë -II- e Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë 29.02.2023 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e Kuvendit të Komunës. Të pranishëm ishin: **Mehmet Ballazhi** (Kryetar i Komunës), **Majlinda Kaloshi** (Drejtoreshë për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm), **Lindita Ballazhi** (Drejtoreshë për Buxhet dhe Financa), **Arsim Dernjani** (Drejtor për Shërbime Publike dhe Emergjencë), **Nexhmedin Daci** (Drejtor për Urbanizëm Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), **Kimete Kuka -Hasallari** (Drejtoreshë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), **Natyra Kalisi** (Drejtoreshë e Administratës), **Abduraman Bushi** (Drejtor për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural), **Hisni Luri** (Drejtor për Arsim), **Arbenita Bajramaliu** (Drejtoreshë për Kulturë, Rini dhe Sport), **Sara Berisha** (Asistente e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës), **Sevime Bajrami** (Kryesuese e Komisionit të Aksionarëve të NPL Pastrimi), **Sara Berisha** (Asistente e Kryesuesit të Kuvendit), Kryesuesi pasi konstatoi prezencën e anëtarëve të kuvendit, konstatoi se nuk mungon asnjë anëtarë i Kuvendit të Komunës.

### RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Raporti i punës së kryetarit të komunës për vitin 2023.
3. Raporti i punës së kuvendit të komunës për vitin 2023.
4. Propozim vendim për shpalljen me interes të përgjithshëm të gjashtë parcelave kadastrale.
5. Raporti financiar për vitin 2023 i N.P.L "Pastrimi" sh.a.
6. Informatë mbi procesin e trajtimit të ndërtimeve pa leje dhe legalizimin e tyre.
7. Të ndryshme.

**Kryesuesi** thekson:-për pikat e rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim, rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

## 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

**Kryesuesi** thekson:- a keni ndonjë vërejtje rreth procesverbalit,

**Hyrijete Isufi** thekson:- te diskutimi imë , te pohimi i dytë i imi kam potencuar se propozoj që të vendosen dollap për telefona e jo për llaptop.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

### U MIRATUAR PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

## 2. Raporti i punës së kryetarit të komunës për vitin 2023.

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- sot po bëhet transmetimi për herë të parë i seancave të kuvendit dhe kjo është një prej të arriturave sepse kemi bërë transmetimin e seancave në mënyrë të drejtë për drejtë. Te raporti i punës për vitin 2023 natyrisht përfshihen punët e gjithë vitit në bashkëpunim me gjithë stafin e komunës të secilit sipas përgjegjësive të tyre. Në raport janë paraqitur marrëveshjet e bashkëpunimit që është një numër i konsiderueshëm i tyre afër pesëmbëdhjetë apo gjashtëmbëdhjetë marrëveshje. Është me rëndësi të potencohet subvencionimi i studentëve që është rritur numri në katërdhjetë që përfshinë shumë prej njëzetë mijë euro dhe veçantia e kësaj është se për herë të parë janë përfshirë në vendet për rreth në universitet publike me fokus të Maqedonisë. Janë stimuluar edhe organizatat joqeveritare të cilat kanë përfutur numër rekord duke përfshirë ata të fushës sportive kulturore dhe të tjera në shumë totale njëzet e gjashtë mijë euro . Subvencione tjera përfutuesit individual duke përfshirë lehonitë dhe rastet e ndihmesës shëndetësore që tejkalojnë shumë mbi dhjetë mijë euro . Subvencione në bujqësi duke përfshirë serra perime në vlerë prej njëmbëdhjetë mijë e pesëqind euro. Vitin e kaluar është mbajtur festivali folklorikë që ne synojmë të jetë tradicional e që organizohet në datat nëntë, dhjetë dhe njëmbëdhjetë qershor . Përkrahje për vendosjen e shkronjave të UQK-së. Themelimin e mekanizmit për parandalimin e radikalizmit, pjesëmarrjen në panairin ndërkombëtarë të sportit dhe turizmit. Themelimin e ekipit për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, si dhe themelimin e mekanizmit kundër dhunës në familje. Materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

**Resul Suma** thekson:- së pari ju përgëzojë për rritjen e nivelit të transparencës përmes transmetimit lajv të seancave të kuvendit. E dimë që janë bërë shumë punë në vitin 2023. Uji është dorëzuar nga komuna në menaxhim të “Bifurkacionit” dhe qytetarët po kanë ankesa dhe ankesat a mi drejtuar te drejtori apo te kompania “Bifrukacioni” për shkak se ka ankesa sidomos në faturim . Unë e kam një faturë që ma dërguar një qytetarë që fatura i ka ardhur katërdhjetë euro. A është duke u transmetuar lokacioni i gjibiesëve në veb faqe apo vetëm te Drejtoria e Administratës. Sipas raporteve të Bifurkacionit a është i pishëm uji.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- e kemi sqaruar edhe në seanca të tjera të kuvendit dhe ajo që unë e konsideroj të arritur është që ja kemi kaluar përgjegjësinë e menaxhimit të ujit në kompaninë “Bifurkacioni” të menaxhimit të ujërave dhe gjithçka që kanë paqartësi qytetarët “Bifurkacioni” duhet ta sqaroj e jo që na nuk ju dalim në ndihmë qytetarëve për me i orientuar se ku duhet të bëhen këto kalkulime për çështjet që unë i bëjë por i orientojmë të “Bifurkacioni” edhe pse mund të ketë probleme ndoshta një kohë pak më të gjatë deri sa të vije deri te rregullimi i faturimit, por e mira kësaj është që ka filluar të futet në menaxhim duke shpresuar që shumë shpejtë të rregullohen. E fundit ka qenë raporti i institut kombëtar të shëndetësisë të cilët kanë marr mostrat e ujit dhe kanë bërë hulumtimin e ujit se sa është i pishëm, te shkolla fillore është raporti zyrtarë që Institutit konsideron se sipas analizave është i pishëm dhe në sa lokacione është marrë nuk e di me saktësi por te shkolla fillore është një raport zyrtarë që uji është i pishëm.

**Natyra Kalisi** thekson:- automjetet lokalizohen në kohë reale dhe kjo ka qenë arsyeja që i kemi bërë këto vendosje të gjibiesëve për shkak të menaxhimit të plotë të automjeteve të cilët i kemi në komunës por njëkohësisht edhe për sigurinë e automjeteve.

**Sherif Berisha** thekson:- pikë së pari më vjen mirë që kjo seancë po transmetohet dhe qytetarët e kanë mundësit që ta shohin seancën sepse ky ka qenë njëri ndër premtimet e juaja që seancat e kuvendit do të transmetohen direkt gjë e cila deri më sot nuk ka ndodhur edhe pse në kuvendet e më hershme është marr ky vendim. Aq sa kemi njohuri për këtë aktivitet të juajin keni shpenzuar buxhet për blerjen e disa telefonave për transmetimin e mbledhjeve të kuvendit që tani po del që këto shpenzime janë bërë kot. Në raportin e punës së Kryetarit në letër duken se janë bërë një nam punësh por realisht qytetarët nuk po i shohin. Në projektet të cilat jeni zotuar se do t'i përfundoni në dy vitet e para të mandatit po duket se ende nuk i keni filluar, çështja e ujit vazhdon të mbetet shqetësim i madh i banorëve të Hanit të Elezit. Janë shpenzuar 30 000 € për vendosjen e ujëmatësve në Lagje të Re dhe në Han të Elezit dhe aq sa ne e dimë që Lagja e re dhe Hani i Elezit i kanë pasur të vendosur ujëmatësit, pra ku janë vendosur këto ujë matës dhe a mendoni që janë shpenzuar shumë mjete për këtë aktivitet. Çështja tjetër është se çfarë ju keni bërë me ato familje që nuk kanë pranuar të kyçen në ujësjellës, pa varësisht që po menaxhoni çështjen e ujit po bëni edhe diferencime te qytetarët. Qytetarët e ndershëm që nuk kanë refuzuar të vendosin orëmatësit po pësojnë nga pagesa. Qytetarët e pandërgjegjshëm që nuk kanë vendosur orëmatës janë përfitues dhe kalojnë pa pagesë të ujit. Si lëvizje vetëvendosje jemi të mendimit që shpenzimet një vjeçare ti bartë komuna e jo në kurriz të qytetarëve . Si lëvizje vetëvendosje kur është miratuar buxheti për vitin 2024 kemi kërkuar që të ndahet buxhet për rregullimin e problemit të ujit një herë e përgjithmonë që nuk e keni përkrahë aspak dhe keni shpenzuar por tani çështja e ujit mbetet e njëjtë. Në raportin e juaj keni shënuar që si zyre ligjore keni bashkëpunuar me gjithë sektorët e komunës që kemi arritur që pajtueshmëria e akteve komunale të jetë në pajtim me legjislacionin në fuqi e në realitet nga këshillat e zyrës ligjore keni shumë vendime të kthyera nga këshilli i pavarur mbikëqyrës , pra po del që zyra ligjore nuk po punon me legjislacionin në fuqi. Gjitha vërejtjet janë dhënë për shërbyesit civilë dhe janë kthyer pas ankesave të punëtorëve. Gjithashtu është potencuar se pas marrjes së gjitha aktgjykimeve në shkallën e parë të gjykatës kemi bërë ankesa në gjykatën e shkallës së dytë vlen të theksohet dhe dihet se për cilat aktgjykime bëhet fjalë. Te zyra e prokurimit pse është anuluar procedura e infrastrukturës shkollore në gjitha shkollat dhe ku janë shpenzuar këto mjete pas anulimit të kësaj procedure . A është vendosur gjibiesi në veturën e nënkryetarit të komunës . Te drejtoria e shëndetësisë pres të marr përgjigje rreth participimeve për pyetjen që e kam parashtruar në Komitet për Politikë e Financa. Çështja e stafit te Drejtoria e Shëndetësisë është shënuar në tabelar se punoni me 33 ndërsa nëse numërohet stafi del që janë 32 punëtorë sepse në vitin 2023 keni pasur 32 punëtorë në planifikim të buxhetit dhe si është e mundshme me u rrit numri . Te të hyrat vetanake keni shënuar se për vitin 2023 keni grumbulluar 9060 € , ndërsa te drejtoria e financave është një shumë tjetër që do të thotë është një mos përputhje . A keni mundur të bëni zgjidhje për mjek familjarë për shkak se qytetarët shumë shërbime po i marrin në komunën e Kaçanikut. Drejtoria e arsimit a keni bërë zgjidhje për projektorë dhe llaptop. Te subvencionimi i sporteve jeni në konflikt të interesit me që janë subvencionuar të gjithë drejtorët, mësimdhënësit për aktivitet sportive të realizuara . A keni për pagesën keni filluar me pagesë për sallat sportive.

**Mehmet Ballazhi** thekson:-u përmend çështja e telefonave për transmetim të seancave, unë besoj që deri tash ke ndërruar telefona më shumë dhe nuk e ke telefonin e parë kur ke filluar me telefon se është çështje teknologjie kjo. Në fillim i kemi transmetuar me telefon tash e mira është që besoj që pajtohesh edhe ty që po i transmetojmë me drejtë për drejtë që besoj që pajtohesh edhe ti. Nëse materiali të ka pëlqyer si i mrekullueshëm në teori po të garantojë me një far forme se po mos me u bërë puna e mrekullueshme është problem me qenë në teori të mrekullueshme kjo është arsyeja që ka dalë i mrekullueshëm . Te qytetarët e ndershëm e të pa ndershëm, ndërgjegjshëm e të pa ndërgjegjshëm , besoj që është gabim me i cilësuar kështu njerëzit sepse ai që nuk ka pranuar me vendosur ujë matësin nuk mundemi me i thënë që është i pa ndërgjegjshëm dhe i pa ndershëm , mund të ketë një problem një pakënaqësi por ne merremi me të dhe kjo është arsyeja e pyetjes tjetër pse si kanë vendosur gjitha por është proces dhe nuk bëhet për një kohë shumë të shkurtë prandaj cilësime të tilla janë të pa pranueshme sipas meje . Vendimet e kthyera nga këshilli i pavarur potencove që ka shumë dhe shumë është si ta kalon njëshin e dyshin janë shumë por sigurisht ka edhe vendime të cilat janë kthyer pozitivisht pra ka një numër të caktuar . Të hyrat vetanake mund të ketë mos përputhje për ndonjë gabim teknik por e sqarojmë. Jemi në procedura të zgjedhjes së mjekut familjarë.

**Hisni Luri** thekson:- sa i përket procedurës së prokurimit për infrastrukturën shkollore ne e dimë që në të gjitha shkollat e kemi rregulluar infrastrukturën shkollore, procedurat ndoshta kanë mundur me u shtyer te prokurimi por nuk është që merremi ne me ta. Sa i përket shkollave dhe investimeve besoj që i keni parë edhe të publikuara dhe mund të ua sjellim edhe dëshmitë dhe raportet se çka është punuar nëpër shkolla. Për çështje të projektorëve dhe llaptopëve e dimë që fillojnë të amortizohen se janë material që amortizohet me kohë por ne gradualisht jemi ka i rregullojmë edhe këto çështje që për çdo vjet llaptopët që janë më të lodhur po mundohemi me i zëvendësuar me llaptop të rijë, mirëpo nuk po dua me investuar për shkak se jemi në pritje të një donacioni prej ambasadës së Suedisë që ju ka dhuruar Ministrisë së Arsimit e që do të jetë me faza që do të përfshihen të gjitha shkollat. Katalogjet i kemi plotësuar për këto pajisje të cilat neve na shërbejnë për mësimdhënie dhe nëse nuk realizohen deri nga muaji gjashtë i këtij viti ne do t'i zhvillojmë procedurat vetanake. Sa i përket sallave të sporteve është e fokusime që të paguhet një far takse për shfrytëzimin e atyre hapësirave shkollore por të gjitha organizatat që veprojnë në komunën tonë janë të liruar nga taksa.

**Kimete Kuka –Hasallari** thekson:- sa i përket mungesës së mjeteve financiare për të cilat ke kërkuar në mbledhje të KPF-së por raportet të cilat vijnë prej QKMF-së gjithçka përputhet me bllokat dhe participimet që i kemi si shëndetësi. Me buxhet qeveritarë jemi me 32 pozita në QKMF dhe për shkak të mungesës së drejtorit kjo pozitë është me ushtrues detyre dhe jemi me 31 punëtorë. Në tërë Kosovën është mungesë e theksuar çështja e mjekëve familjarë por ne bashkëpunim me shoqatën “Islamik Relief” do të mundohemi me bërë zgjidhje që certifikatat me u lëshuar nga QKMF-ja e jonë.

**Arsim Dernjani** thekson:- është bërë ndërrimi i gypit të ujës jellësit në fshatin Gorancë nga vendi i quajtur Sodonec deri te bazeni i ujit, është bërë zgjerimi i rrugës atje, është shtruar me beton bazeni në fshatin Dimcë dhe janë vendosur tre hidrantë, dy në fshatin Gorancë dhe një te zjarrëfiksat.

**Sherif Berisha** thekson:- në mbledhje të KPF-së i kam parashtruar dy pyetje por nënkryetari ka potencuar që nuk të jap përgjigje. Mjetet financiare të cilat kanë qenë të dedikuar për te shkolla ku janë shpenzuar pasi është anuluar tenderi. Përgjigje nuk më është dhënë për çështje të subvencionimit.

**Natyra Kalisi** thekson:- u potencia që keni blerë disa telefona por faktikisht është blerë vetëm një telefon dhe ai telefon është përdorur për aktivitet e Kuvendit Komunal për transmetim të seancave dhe për aktivitet të tjera të komunës, për ndryshe telefoni është në komunë dhe përdoret për këto aspekte nuk është që keqpërdoret dhe kur është miratuar plani i punës ka qenë e përfshirë edhe kjo procedurë e prokurimit e cila ka shkuar në bazë të rregullave dhe dispozitave ligjore. Sa i përket gjibiesit të automjeti i Nënkyetarit , faktikisht automjet nënkryetari nuk ka por është automjeti i Komunës dhe është automjet që nuk ka gjibiesë për shkak se është vendim i joni si ekzekutivë që mos me pasur gjibiesë.

**Hisni Luri** thekson:- subvencionimi i drejtorëve dhe mësimdhënësve në esencë mund të doket kështu por unë veprojë me letra dhe me letra nuk është asnjëri siç potencuat.

**Nora Xhoni** thekson:- fillimisht të përgëzojë për këtë të arritur për transmetimin drejtë për drejtë të seancave të Kuvendit të Komunës e cila është kërkuar me vite dhe shpresojë që kjo e arritur e sjellë të arriturën tjetër ujin që edhe atë jemi duke e kërkuar me vite. Rregullimi i parqeve dhe i hapësirave publike ja kanë dhënë një pamje shumë të bukur vendit tonë duke u lidhur nga fakti se verën e kaluar kanë qenë disa pakënaqësi të mos mbajtjes së pastërtisë dhe a do ta keni parasysh në vitin 2024 që të ketë mirëmbajtje për këto parqe që mos të dëmtohen.

**Refet Kalisi** thekson:- çështja e ujit është problem që katër dhjetë vite dhe nuk e kemi sot unë kam qenë i kyqur tetë vite dhe nuk kemi bërë zgjidhje edhe pse jam mundur. Një zgjidhje në këtë vit është bërë që do të thotë 50 % është realizuar por edhe në instalimin e gypave kemi problem se e dijë këtë çështje e nuk jam vetëm me kritikuar pa argumente sepse kanë me potencuar se po ja mbanë anën Kryetarit por jam i këqyr në atë problem dhe për atë po bisedojë. E kam një apel te të gjithë ne sepse duhet të apelojmë që të bëhet pagesa ujit dhe unë si qytetarë e kam paguar edhe faturën e parë por duhet ta bëjmë të gjithë . Ka edhe harxhime të ujit për shkak të instalimit që nuk dihet se ka shkon uji sepse ujë ka boll. Pasi është vlerësuar që uji është i pishëm ne të vlerësohet edhe te qytetarët dhe ne të del me një komunikatë “Bifurkacioni” në qoftë se uji është i pishëm për shkak se uji vjen i pastër edhe pse ka ndonjë herë turbullira të cilat vijnë për shkak të gypave që nuk janë pastruar që nga një herë kur lëshohet uji shtypja e madhe mundet me i pastruar gypat dhe mundet me u ndotur . Ju kuptova Kryetarë që potencuat që “Bifurkacioni” e ka përgjegjësinë dhe e ka por qytetari vjen të drejtori dhe te Kryetari i Komunës ja kërkon ujin. Janë probleme që nuk kanë me u ndalur asnjë herë dhe edhe na duhet të kontribuojmë në këtë punë për shkak se është problem çështja e ujit. Te të hyrat komunale për tatimin në tokë për vitin 2023 nuk ka mjete të inkasuar.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- te parqet edhe ne i kemi pasur pakënaqësitë tona te mirëmbajtja jo e duhur e mjaftueshme e parqeve për shkak të verës që ka qenë shumë e nxehtë kemi qenë të pa përgatitur për atë verë të nxehtë por në këtë vit kemi me marr masa dhe nuk do të jetë i njëjti problem. Për pa pastërtinë që ndodhë, për vandalizmin që ndodhë është një çështje që po mundohemi me bashkëpunuar me të gjithë faktorët dhe me Bashkësinë Islame në takimet që kam pasur e kemi diskutuar çështjen e vetëdijesimit për mirëmbajtjen dhe kujdesen e këtyre hapësirave publike. Te çështja e ujit faleminderit z.Refet për vlerësimin, një vlerësim shumë real i kuptueshëm dhe jo rastësisht potencova që e dinë çështjen e problemit të ujit dhe je mundur me punuar gjatë kësaj periudhe sa ke qenë drejtor i Shërbimeve Publike dhe e kuponë shumë më mirë edhe problemin e zgjidhjes së çështjes së ujit por kjo është një proces ashtu siç e kemi diskutuar edhe disa herë më herët që jemi mundur me sqaruar që jemi në proces. Ne kemi investuar te fabrika e ujit por edhe në fshatin Gorancë, edhe në ujëmatës dhe tash së fundi ka qenë një donacion të gjeneratorit. Qytetarët e di që orientohen në Komunë te Kryetari i Komunës, te drejtorët por edhe te ju anëtarë të kuvendit por çdo kërkesë që ta parashtron së bashku ne do të mundohemi që ta realizojmë por ajo që është e rëndësishmja është vetëdijesimi i qytetarëve për pagesën e shërbimeve dhe kjo është e domosdoshme. Lagjia e Re ka pasur problem me menaxhimin e ujit për deri sa nuk ka hyrë në menaxhim por tash mundem me potencuar që njëzet e katër orë ka ujë atje, fshati Gorancë ka njëzet e katër orë ujë pra në mënyrë parciale po i zgjidhim problemet, këtu është kjo zgjidhje që është bërë është uji i pastër, pastaj vazhdojmë me menaxhimin e ujëmatësve, me kryerje të shërbimeve, eliminimin e defekteve, kyçjeve ilegale pra është një proces që ka me na zgjatur dhe ka me na marr kohë më shumë.

**Nexhmedin Daci** thekson:- është gabime teknike teknik ajo e viti 2022 është për vitin 2023.

**Erbli Meliqi** thekson:- ju përgëzoj për transmetimin e seancave në mënyrë të drejtë për drejtë se ka qenë premtim elektoral i Kryetarit z.Mehmet Ballazhi ju përgëzoj për punën e arritur. Te drejtoria e administratës është shënuar që janë ndarë mjete për rifunksionalizimin e kamerave si në zonën rurale dhe urbane por a mundeni me kërkuar raport në Këshillin Komunal për Siguri se a janë funksionale të gjitha kamerat sepse kanë ndodhur disa incidente që disa janë zgjidhur e disa nuk janë zgjidhur. Te drejtoria e shëndetësisë i pashë raporte për sëmundjet malinje të cilat kanë qenë gjatë vitit 2023 dhe 2022 , a mundeni me kërkuar raport prej drejtorit të QKMF-së se sa raste aktive janë me sëmundje malinje në komunën tonë.

**Natyra Kalisi** thekson:-projekti i vendosjes së kamerave dhe rifunksionalizimin e kamerave të sigurisë ka qenë një projekt i realizuar në vitin 2023 i cili është në shumë prej 4846.00 € . Sa i përket raportit se a janë funksionale kamerat e sigurisë unë personalisht nuk marr pjesë në Këshillin Komunal për Siguri dhe nuk mundem me kërkuar atë raport, mirëpo në kontaktet të cilat i kam me policinë kanë parashtruar kërkesë që kamerat nuk janë në funksion por kur e kam kontaktuar operatorin ekonomik kamerat kanë qenë të hequra prej prizmit elektrik dhe kompania i ka verifikuar dhe i ka vendosur në prizëm elektrik dhe janë funksionalizuar.

**Kimete Kuka –Hasallari** thekson:- sa i përketë sëmundjeve malinje nuk është numri real për shkak se ka pacientë që vetëm i marrin terapitë në QKMF pa e pasur ndonjë dokumentacion të rregullt që duhet me u regjistruar si i sëmur me sëmundje malinje dhe nuk kemi të drejtë me qit në raporte publike për derisa nuk i kemi të regjistruar në sistem sepse realisht trajtohen nëpër spitale private e shumë pak janë që marrin trajtim dhe shërbime këtu.

**Malik Berisha** thekson:- i pashë dy pozita mjekë të mjekësisë familjare por nuk janë mjekë të mjekësisë familjare por janë mjek të përgjithshëm do të thotë pozitë e realizuar me sukses , po ashtu pashë edhe disa të tjera logoped dhe psikolog që shënon që pozita nuk është shpallur fare, kërkoj sqarim për këtë çështje.

**Kryesuesi** thekson:-nëse je i pajtimin për këtë pyetje që e parashtrove përgjigjen do ta japim në seancën e radhës.

**Hyrijete Isufi** thekson:- te shërbimet për vitin 2022 dhe 2023 numri i aplikuesve të rinj është zvogëluar por në përshkrimi në anën tjetër përdorimi i substancave narkotike në vitin 2022 ka qenë një dhe për vitin 2023 nuk ka pasur dhe urojë të jetë kështu . Kërkoj sqarim sa janë në trajtim apo pse është hequr në vitin 2023.

**Kimete Kuka –Hasallari** thekson:- qendra për punë sociale jep këshilla psikologjike sociale dhe nuk merret me trajtimin personalisht me ta.

**Zaim Bela** thekson:- te zyra ligjore kam vërejtje te faqja numër tetë se çdo vendim i drejtorëve është mirë me shkuar te zyra ligjore në mënyrë që mos me bërë gabime sepse edhe z.Sherif Berisha potencojë që janë kthyer disa vendime të cilat nuk kanë qenë në përputhshmëri. Në faqen tetë që është paraqitur tabela vërehet që është gabim teknik askund nuk shihet një shifër e vitit 2023 dhe lartë shënon raport ndërsa i ke 2021 dhe 2022 .

**Sherif Berisha** thekson:- te drejtoria e financave ty ku keni potencuar që sipas dispozitave ligjore pas pranimit të faturave të tatimit në pronë dhe tokë qytetarët kanë parashtruar 54 kërkesa , për çfarë ankesa bëhet fjalë dhe kurdo të fillon implementimi për faljen e borxheve në shumë prej njëqind euro.

**Lindita Ballazhi** thekson:- sa i përket ankesave të cilat janë bërë në kuadër të sektorit të tatimit në pronë pas pranimit të faturave hapet faza e pranimit të ankesave te qytetarët te tatimi në pronë dhe në tokë dhe gjithsejtë kanë qenë 54 kërkesa për korrigjim ndaj certifikatës së pronës, një ankesë ndaj certifikatës së vlerësuar të tatimit në pronë, tri ankesa ndaj faturës së tatimit në pronë si dhe ankesa të tjera të cilat janë të natyrave të ndryshme dhe në detaje më të thella mund ta përgadis materialin për seancën e radhës . Pas marrjes së vendimit nga Kuvendi i Komunës departamenti i tatimit në pronë automatikisht i ka minusuar në sistem për çdo tatim pagues faljen e tatimit në shumë deri në njëqind euro.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

### 3. Raporti i punës së kuvendit të komunës për vitin 2023.

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Resul Suma** thekson:-falënderoj për punën dhe korrektësinë të cilën e bënë si kryesues i kuvendit. Kam dëgjuar se je duke i mbajtur disa takime me kompaninë “Sharrcem” çfarë projekte janë duke u diskutuar dhe që do të realizohen për këtë vit.

**Kryesuesi** thekson:-kjo pyetje më shumë është për me u parashtruar te pika e rend të punës të ndryshme dhe te ajo pikë do të jap përgjigje.

**Sherif Berisha** thekson:-do t'i bashkëngjitëm parafolësit për hapësirën të cilin e kemi pasur në seancat e kuvendit.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

#### U MIRATUA RAPORTI I PUNËS SË KUVENDIT PËR VITIN 2023

#### 4. Propozim vendim për shpalljen me interes të përgjithshëm të gjashtë parcelave kadastrale.

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Nexhmedin Daci** thekson:- në pajtim me ligjin për shpronësimin e pronës së pa luajtshme drejtoria e urbanizmit në bashkëpunim me Kryetarin e Komunës i propozon Kuvendit të Komunës që të shpall me interes të përgjithshëm publikë gjashtë parcela gjatë rrugës së Egzodit dhe të gjithë këto parcela janë private. Në material i keni të gjitha të dhënat për këto parcele me sipërfaqe. Fjala është për rrugën që shkon te kompleksi memorial "Bllaca 99". Ministria e Zhvillimit Rajonal ka miratuar kërkesën e komunës për bashkëfinancimin e rregullimit të asaj rruge pra shtrimin me asfalt. Besojmë thellësisht se shpronësimi i këtyre parcelave private është me interes të veçantë publik në mënyrë që kjo rrugë komplet të jetë në pronësi publike andaj ju bëjë thirrje që ta votoni këtë propozim vendim.

**Zaim Bela** thekson:- a është kjo rrugë që shkon te "Bllaca 99" dhe a është shpall ajo rrugë publike apo është ende private.

**Nexhmedin Daci** thekson:- atë rrugë fillimisht e ka hapur pronari i Gurit Bekuar z.Muhamet Kalsi deri te Ura, në vitin 2020 Ministria e Infrastrukturës e ka vazhduar atë rrugë deri te "Bllaca 99" dhe me njëherë nëse e kalon hekurudhë mbrapa fushës së futbollit janë katër parcele me sipërfaqe të vogla janë prona private në pronësi të Gurit të Bekuar, më poshtë e z.Mevludin Kuka , z. Xhemshi Luri pra këto parcela janë prona private pjesa tjetër deri të Bllaca 99 është pronë publike por rruga me qenë publike është e domosdoshme edhe këto parcele me u shpronësuar.

**Refet Kalisi** thekson:- rrugën e Gurit të Bekuar që e shfrytëzon kompania Alba që e ka blerë atë pronë a komuna do ta shpronëson atë rrugë dhe pse me shpronësuar komuna atë rrugë se edhe kompania e shfrytëzon atë rrugë nuk e shfrytëzon vetëm komuna. Kemi shumë rrugë për me shpronësuar dhe qytetarët mund të kërkojnë mjete financiare për ato rrugë dhe shtrohet pyetja se ku do të marrim mjete financiare për me ua kompensuar.

**Nexhmedin Daci** thekson:- nuk është puna vetëm e kompanisë Alba por është fusha e futbollit, është projekti Bllaca 99 ku është bërë investimi, kompania Sharrcem i ka interesat në aktivitetet minerare. Nuk mundemi me lënë ashtu për shkak se është pronë private dhe në momentin që mundet me u tërhequr prej biznesit mundet me potencuar që është pronë e imja dhe mundet me mbyll dhe mirë është që ajo rrugë me qenë kompletë pronë publike mos me pasur problem as kërkesa.

**Sherif Berisha** thekson:- kërkesa është e Gurit Bekuar por qytetarët duhet ta dinë se për kënd bëhet fjalë.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- ajo rrugë nuk është me rëndësi e kujt është si pronë dhe kush ka me shfrytëzuar sepse fundi fundit çdo qytetarë ka me shfrytëzuar kush do që të jetë ai. Rruga që e kemi propozuar për me shpronësuar lidhet me Bllaca 99 dhe nëse nuk bëhet ajo rrugë publike në të ardhmen mund të kemi probleme për me shtruar me asfalt për shkak se mund ta ndalon nëse është private, pra duhet me pasur një rrugë publike që shkon te Bllaca 99 dhe mund ta shfrytëzojnë edhe pronarët e tjerë të cilët kanë parcela në atë pjesë .

**Sherif Berisha** thekson:-në Komitet për Politikë e Financa kemi pasur problem rreth sqarimeve për këtë pikë të rendit të punës dhe drejtori ka qenë bashkëpunues në këtë drejtim por nënkryetari është sjell shumë keq. Këshilltarët e tu a ty përcjellin saktë ato që ndodhin në KPF dhe ku do qoftë.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- këtu jemi në Kuvend për me i sqaruar dhe diskutuar me ju dhënë zgjidhje pikave të caktuara sipas rendit të punës të cilin e keni miratuar ju dhe nëse zgjerohemi në çështje të tjera dhe për diçka që të mundon personalisht mund të vishë te unë dhe shihemi edhe në jetë e përditshme dhe nuk besojë që ky është ambient që me i sqaruar disa çështje që na mundojnë politikisht.

**Kryesuesi** thekson:-urojë që edhe parcelat tjera që janë private të shpronësohen dhe të bëhen publike për shkak se kjo është rrugë publike dhe unë mendoj që nuk ka diçka të keqe por po bëhet një punë e mirë. E përgëzoj drejtorin është bashkëpunues sepse në KPF kemi pasur një vërejtje te ortofotot dhe drejtori i ka ofruar.

**Nexhmedin Daci** thekson:- këto parcela janë duke u shpallur me interes publik ndërsa shpronësimi është fazë tjetër dhe pas kësaj kjo kalon te zyra e Kryetarit dhe Kryetari merr vendim preliminarë të shpronësimit dhe njoftohen palët e gjatë njoftimit dikush mundet me najë falë pronën. Nuk duhet të përzihet shpronësimi me interesin e përgjithshëm.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte 13 për 1 kundër (prezent në sall ishin 14 këshilltarë komunal).

**U MIRATUA PROPOZIM VENDIMI PËR SHPALLJEN ME INTERES TË PËRGJITHSHËM TË GJASHTË PARCELAVE KADASTRALE**

#### **5. Raporti financiar për vitin 2023 i N.P.L “Pastrimi” sh.a.**

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Sherif Berisha** thekson:- gjatë takimit që kemi pasur me komisionin e aksionarëve kemi ardhur në përfundim që të shikohet mënyra ligjore për pagesën e komisionit të aksionarëve.

**Zaim Bela** thekson:-shoferët me kategori të lartë dhe me një pagë shumë të ulët por unë mendoj se ndoshta do të largohen për shkak se shoferët po kërkohen në të gjitha anët me pagë 700 € deri në 800 €. Në informatë shënon që janë ngritur pagat në shumë prej 50 € janë ngritur prej muajit dhjetor dhe pashë që numri i punëtorëve ishte bajagi i mirë por me të vërtetë pagat janë shumë të vogla.

**Nora Xhoni** thekson:- vitin e kaluar ka pasur ndryshim të orareve në muajin Ramazan a do të ketë ndonjë njoftim për këtë çështje.

**Refet Kalisi** thekson:- shpenzimet janë me të rritura në krahasim se në vitin e kaluar , shpenzimet për zyre dhe administratë janë në shumë prej 3145.00 € , vitin e kaluar kanë qenë 378.00 € . Shpenzimet për trajnim, kërkoj sqarim se për çfarë trajnimi bëhet fjalë.

**Kryesuesi** thekson:-nëse do të ketë ndonjë ndryshim të orarit do të njoftoheni me kohë, ndërsa për pyetjet që i parashtror z.Refet Kalisi përgjigjet do të jepen në seancën e radhës. A keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.



## 6. Informatë mbi procesin e trajtimit të ndërtimeve pa leje dhe legalizimin e tyre.

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Nexhmedin Daci** thekson:- materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

**Refet Kalisi** thekson:-është mirë të bëhet një sensibilizim më i madh përmes shpërndarjes së broshurave sepse është edhe në favor të komunës por edhe të qytetarëve që ta bëjnë legalizimin.

**Nexhmedin Daci** thekson:- është edhe në vebfaqe të komunës dhe fletushkat i kemi në hyrje të komunës dhe ky proces i legalizimit është prej vitit 2014 por me siguri qytetarëve ju duket që ka një kosto të shtrenjtë .

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

## 7. Të ndryshme.

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Resul Suma** thekson:- te arsimi kam një çështje me diskutuar për transportin e nxënësve të fshatit Krivenik prej shkollës së fshatit Seçishtë . Gjatë bisedave që i kemi pasur me banorët kemi potencuar që transportin kemi me ua siguruar përmes komunës dhe komuna për atë transport i jep njëmbëdhjetë mijë euro dhe me datë njëzetë e një dhe njëzet e dy shkurt nuk është bërë, por është bërë pasi kanë pritur tri orë nxënësit. Ato nxënës janë nga klasa e parë deri në klasën e pestë dhe është e tmerrshme një nxënës shtatë apo tetë vjet me pritur tri orë duke marr parasysh që është larg fshatit të tyre. Është mirë me i dhënë vërejtje operatorit ekonomik . Te shëndetësia e kemi kërkuar që njëra prej barnatoreve me punuar njëzet e katër orë për shkak se nëse QKMF-ja punon njëzet e katër orë pacientët kanë nevojë me pasur edhe një barnatore hapur sepse nuk munden me qenë të varur që nëse vetëm ndonjë infermier i ka çelësat e barnatores.

**Hisni Luri** thekson:- sa i përket transportit për në fshatin Krivenik kemi marr masa dhe e kemi diskutuar me operatorin sepse kam pasur ankesa edhe nga prindërit por nuk është ashtu siç po potencon ty për shkak se për me gjykuar një rast duhet me i marr dy palët. Është e vërtet që kanë mundur me pritur por te transporti kur bëhet bartja e nxënësve është një far rregullore sepse orarin e kemi bërë që të jetë fleksibilë për ato nxënës e duhet me pasur parasysh edhe prindërit orarin dhe për dy apo tre fëmijë pse i bien një orë me pritur pak më shumë duhet me qenë të mirëkuptueshëm në këtë pjesë. Zënkat në mes nxënësve që ndodhin në atë automjet unë nuk mund të jap përgjegjësi për ta duhet me i menaxhuar ai që i bartë dhe deri tash shumë mirë ka menaxhuar . Përfaqësuesi i kompanisë në biseda që kam pasur ka potencuar që ka pasur një defekt në kombibusë dhe i kam dhënë vërejtje që mos me u përsëritur kjo pjesë.

**Kimete Kuka –Hasallari** thekson:- sa i përket çështjes së barnatoreve jemi duke e shqyrtuar mundësinë dhe kjo çështje i bien drejtorisë për zhvillim ekonomikë dhe jemi duke i shikuar mundësitë . Kemi pasur një takim dhe duhet me i marr mundësitë edhe të bizneseve për shkak se nuk mundemi me ua obliguar barnatoreve sepse janë private pra duhet të merret edhe pëlqimi i tyre nëse pranojnë të kenë kujdestari.

**Sherif Berisha** thekson:- te mirëmbajtja e rrugëve të asfaltuara në fshatra dhe lagje a ka fond buxhetorë të ndarë për mirëmbajtjen e tyre kur e dimë që shumë rrugë kur janë ndërtuar kanë kaluar dy automjete tash një automjet me vështirësi mund të kalon një ndër ta që po e përmend është rruga që shkon ka shtëpia e kryesuesit. Me që ministria e Infrastrukturës dhe mjedisit ka filluar me mbledhjen e të dhënave për realizimin e projektit qeveritarë për banim social në të gjitha komunat e Kosovës dhe afati për dorëzim ka qenë deri më datë 22.02.2024 , a keni dërguar të dhëna sa i përket për komunën tonë. Çështja e hedhjes së mbeturinave të forta të cilat po hedhen në fshatin Gorancë , kush ka vendosur me i dërguar ato mbeturina të forta në fshatin Gorancë.

**Mehmet Ballazhi** thekson:-për materialet e ngurta e kemi mbajtur një takim në fshatin Gorancë dhe jemi dakorduar që depoja për grumbullimin e materialeve të ngurta të jetë në fshatin Gorancë . Është një projekt i planifikuar për të cilin edhe mjetet financiare i keni ndarë dhe e keni miratuar atë projekt që do të bëhet në këtë vit në fshatin Gorancë, pra është një depo e më hershme që ka qenë për hedhjen e këtyre mbeturinave dhe herë pas here e kemi shfrytëzuar për arsye se qytetarët kanë nevojë për me i larguar këto mbetje të ngurta. Është miratuar buxheti që janë ndarë mjete financiare për mirëmbajtjen e rrugëve dhe rrugët mirëmbahen prej kompanisë NPL Pastrimi dhe nuk kemi pasur ndonjë vërejtje të veçantë dhe rrugët në Han të Elezit janë mirëmbajtur në mënyrën e duhur .

**Kryesuesi** thekson:-rruga që u përmendë është e kupëzuar 2.5 metra a në fakt banorët e kanë lëshuar që të jetë pesë metra dhe ajo rrugë duhet të mirëmbahet dhe shembja e dheut anës sipër e pa mundëson kalimin e dy automjeteve

**Refet Kalisi** thekson:- unë kam marr iniciativë me i pyetur pronarët por hasa në kundërshtim te Havzi Luri dhe te Gafurri të cilët nuk e kanë lëshuar rrugën për shkak se kanë pronë private

**Kryesuesi** thekson:-unë jam në dioni që në takimin me qytetarët që e kanë mbajtur të gjithë kanë qenë pro dhe nuk besoj që ka kundërshtime por të paktën me u mirëmbajtur.

**Erbli Meliqi** thekson:- e përgëzoj drejtoreshën e kulturës për aktivitetet për nderë të datës së pavarësisë së Kosovës . Ju bëjë thirrje qytetarëve që të jemi sa më të përgjegjshëm sa i përket obligimeve që i kemi ndaj kompanisë sepse ua lehtësojmë punën edhe punëtorëve që punojnë në atë kompani.

**Xhevahir Dernjani** thekson:- nga kolegët e mi dëgjova diskutime rreth çështjes së ujit por qe dy vite kemi arritur te çështja e ujit për qytetarin e Hanit të Elezit por besoj në një të ardhme në këtë projekt edhe qytetari do të ketë ujë të pishëm . Ju përgëzojë për transmetimin onllajn për shkak se qytetarët e Hanit të Elezit të jenë sa më afër me kuvendin apo me kërkesat e qytetarëve që na adresojnë ndaj neve dhe i paraqesim kërkesat e tyre në kuvend.

**Hanumshahe Dibrani** thekson:- nxënësit të cilët janë me aftësi të Kufizuara a ka mundësi me ua vendosur ndonjë dollap te shkolla për shkak të peshave të rënda të çantave.

**Ajnure Thaçi** thekson:- drejtorja ka bërë një marrëveshje për organizimin e javës së kodimit dhe a keni planifikuar që në të ardhme bërë një orë të kodimit nëpër shkolla si lëndë mësimore me qenë .

**Hisni Luri** thekson:- shpresojmë me bërë një zgjidhje për nxënësit të cilët janë me nevoja të veçanta edhe pse Ministria e Arsimit duhet t'i ketë parasysht këto libra të cilat janë me volum shumë të trashë por jemi mundur siç e kemi diskutuar edhe më herët përmes orëve të lëndës së muzikës dhe edukatës fizike me i kombinuar që sa do pak me ja lehtësuar barrën e çdo nxënësi, mirëpo në të ardhmen do ti shohim mundësit që me i vendosë dollapët për libra për gjithë nxënësit. Ne kemi planifikuar që ta kemi edhe orën e kodimit dhe është një arritje e madhe se jemi në shekullin e kodimit dhe do të ju njoftojmë për marrëveshjet kur do t'i realizojmë.

**Refet Kalisi** thekson:- kërkesë kam për koshat e mbeturinave është më mirë me i hequr krejt sepse janë dëmtuar shumë. A keni bërë kontratë me ndonjë kompani për mirëmbajtjen e ndriçimit publik.

**Arsim Dernjani** thekson:- sa i përket shportave për mbeturina e kemi dërguar një projekt me një organizatë dhe jemi në pritje të një përgjigje dhe nëse nuk do të pranojmë ndonjë përgjigje do të shpallim procedurë prej mallrave dhe shërbimeve. Me datë 11.03.2024 bëhet hapja e tenderit për ndriçimin publik.

**Malik Berisha** thekson:- me sa jam në dioni dhe një muaj kemi marrëveshje me Karitasin a keni planifikuar diçka në këtë çështje apo ata me angazhuar përmes organizatës Islamik Relief Kosova.

**Kimete Kuka –Hasallari** thekson:- marrëveshjen të ciline e kemi bërë me Islamik Reliefin janë bajagi mjete që i kushtojnë drejtorisë sonë dhe mjetet financiare po na penalizojnë në çdo aspekt për këto marrëveshje për këtë vit e kemi vështirë por për vitin e ardhshëm do të shohim.

**Resul Suma** thekson:- kam dëgjuar se e kanë fituar të drejtën mësimdhënësit dhe zyrtarët publik për shujtat dhe e di që një shumë kogja e buxhetit për investimet kapitale komplet e marrin ata. Ku kanë mbërrirë punët për këtë çështje.

**Mehmet Ballazhi** thekson:-jemi në proces të implementimit të kësaj kontrate për shkak se ju e dini që është imponuar dhe në Kuvend e kemi diskutuar si problem që do të na shfaqet për shkak të buxhetit të limituar që e kemi në komunë. Sipas kërkesave dhe marrëveshjeve që i kanë bërë me avokatët e tyre unë jam munduar me arritur një dakordim që së paku nëse mundemi një shumë të caktuar ta kursejmë për buxhetin e komunës dhe kam kërkuar që së paku 100 000 € të kursehen nga të gjitha ato shpenzime që krijohen qoftë për avokat , qoftë për gjykatën që së paku diçka të kursejmë . Me avokatët jemi marr veshë që së paku një muaj të na ipet afati i pagesave për ato procese për ato mësimdhënës që arrin përfundimisht gjykata me ua kryer pozitivisht. Është kontratë kolektive që e kanë fituar të drejtën të gjithë mësimdhënësit në gjithë Kosovën por unë kam arritur që së paku disa nga obligimet që shfaqen dhe nëse mundemi me arritur me bërë pagesën mos me shkuar deri te përmbaruesi që edhe ty besoj që diçka kemi me kursyer.

**Ibadete Kalisi** thekson:-pasqyrat e sigurisë në komunikacion shumica nëpër rrugë janë të dëmtuara është mirë që me i ndërruar.

**Arsim Dernjani** thekson:-procedura është në proces dhe nesër bëhet hapja e ofertave për kompanitë që kanë aplikuar dhe në atë ofertë përfshihen edhe pasqyrat e sigurisë.

**Kryesuesi** thekson:- si bord që e kemi me anëtarët e Kuvendit kemi pasur takime me përfaqësuesit e kompanisë Sharrcem dhe i falënderoj përfaqësuesit e kompanisë sepse disa kërkesa tona janë realizuar por kemi edhe disa kërkesa tjera që pritet me u realizuar. Në takimin e fundit që e kemi pasur si bord kemi kërkuar në lidhje me ujin për në fshatin Seçishtë për rregullimin e bazenit dhe kemi hulumtuar parcela të ndryshme ku mundemi me pasur burim të ujit. Me kërkesë të tyre kanë ardhur ekspertë prej Shqipërisë që i kanë lokalizuar pikat ku mundet me pasur ujë dhe si fshat na mbetet me biseduar me pronarin e parcelës. Kemi kërkuar sponzorizimin e sporteve që është gati në finalizim dhe ua kemi përcjellë njoftimin klubeve sportive që ata të jenë të licencuara në gjendje të rregullt me dokumentacion në mënyrë që kompania me i financiar klubet sportive. A keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka shpalli të mbyllur mbledhjen.

Ju faleminderit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 13:00.

**Procesmbajtësi**  
**Ayni Bushi**

